



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1388_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2114_12_20**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 08.06.2021;

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M.RR nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2114_12_20, i datës 14.12.2020.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 14.12.2020 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2114_12_20 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit M.RR nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e faturave të energjisë elektrike të periudhave 03/2020, 04/2020 dhe 05/2020.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori M.RR, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së për këto shkaqe:

- Nuk ka qëndruar në banesë për asnjë ditë të vetme sepse ka qenë kohë e pandemisë dhe asnjë pajisje nuk është shfrytëzuar.
- Pretendon që lexuesi i orës nuk e ka lexuar orën ose dikush tjetër mund të jetë kyçur ilegalisht në orën e saj.
- Kërkon verifikimin e serishëm të kësaj gjendje.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se nuk konsumatori nuk ka qëndruar në banesën e saj dhe asnjë pajisje nuk është shfrytëzuar, Bordi thekson se si i tillë, ky pretendim nuk është relevant, pasi që nga shkresat e lëndës, është vërtetuar se lexuesi i KEDS-it për çdo muaj ka bërë leximin e pikës matëse dhe në asnjë



muaj nuk ka evidentuar ndonjë defekt të pikës matëse. Pas analizimit me kujdes të listave të leximit të KEDS të këtyre periudhave, Bordi ka gjetur se për çdo muaj **gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në listat e leximit përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe të faturave të energjisë elektrike**. Në muajin 01/2020 gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë TL=5235 kWh dhe TU=3046 kWh, në muajin 02/2020 ka qenë TL=5424 kWh dhe TU=3313 kWh, në muajin 03/2020 ka qenë TL=5671 kWh dhe TU=3541 kWh, në muajin 04/2020 ka qenë TL=5992 kWh dhe TU=3780 kWh, në muajin 05/2020 ka qenë TL=6160 kWh dhe TU=3857 kWh, në muajin 06/2020 ka qenë TL=6312 kWh dhe TU=3944 kWh, në muajin 07/2020 ka qenë TL=6433 kWh dhe TU=3998 kWh dhe në muajin 08/2020 ka qenë TL=6547 kWh dhe TU=4250 kWh.

Pretendimi që lexuesi i orës nuk e ka lexuar orën nuk është i saktë, pasi që, siç u potencua më lartë, **leximi i pikës matëse është bërë në rregull** dhe nuk ka defekt në këtë pikë matëse, që nënkupton se nuk mund të ketë kyçje ilegale në këtë njehsor.

Në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë dhe të qartë të profilit të konsumatorit, Bordi ka analizuar Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se nuk është vërejtur ndonjë mos lexim i pikës matëse nga ana e punëtorëve të KEDS-it. Po ashtu, duhet theksuar se konsumatori ka filluar të faturohet me shpenzim të energjisë elektrike ngas periudha 10/2016 e tutje, dhe se nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se nga periudha 10/2016 e deri më 09/2017 nuk ka pasur pothuajse fare shpenzim të energjisë elektrike të regjistruar, apo thënë më saktë ka pasur shpenzim jashtëzakonisht të ulët. Shpenzimi i energjisë elektrike i kontestuar nga konsumatori ka qenë periudha 03/2020 prej 475 kWh, periudha 04/2020 prej 560 kWh dhe periudha 05/2020 prej 245 kWh, ndërsa për të njëjtat periudha të vitit 2019 shpenzimi ka qenë 03/2019 prej 236 kWh, periudha 04/2019 prej 216 kWh dhe periudha 05/2019 prej 180 kWh, si dhe për periudhat e vitit 2018 shpenzimi ka qenë 03/2018 prej 481 kWh, periudha 04/2018 prej 213 kWh dhe periudha 05/2018 prej 183 kWh. Pra nga kjo shihet se **nuk ka ndonjë rritje të madhe të shpenzimit të energjisë elektrike** të periudhave të kontestuara nga ajo të periudhave të njëjta por të viteve paraprake. Duhet theksuar se gjatë periudhës së kontestuar 03/2020 – 05/2020 shihet se ka një rritje të shpenzimit të energjisë elektrike në krahasim me shpenzimet e energjisë elektrike të periudhave tjera të viteve paraprake, por që kjo është normale duke pasur parasysh se gjatë këtyre muajve kontestues 03/2020 – 05/2020 qytetarët nuk kanë pasur të drejtë lëvizje për shkak të masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për shkak të mbrojtjes nga Covid – 19, dhe qytetarët kanë qëndruar në shtëpitë e tyre, andaj duhet theksuar se për shkak të qëndrimit në shtëpi është edhe e natyrshme që shpenzimi i energjisë elektrike të jetë rritur gjatë kësaj periudhe kohore.

Pra, bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike, Bordi konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: **"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim"**. Duhet theksuar se konsumatori nuk ka ofruar asnjë provë me



të cilën do të mund të vërtetonte se nuk e ka nuk e bërë shpenzimin e energjisë elektrike të periudhave 03/2020 – 05/2020.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit M.RR dhe
- Arkivit të ZRRE-së.